

**1. Dokumentacioni i dosjes sipas Formularit TIP 1, Seksioni 8 per Aplikim per Leje Zhvillimore Komplekse:**

- 1- Certifika e pronesise
- 2- Autorizimi i pronarit ( pronareve )
- 3-Fature e pageses se tarifes se aplikimit
- 4-Vertetim i pageses per taksat dhe tarifate vendore
- 5- Plan i Detajuar Vendor ( PDV )
- 6-Plani i Vendosijes se Struktures
- 7-Plani i lidhjes se struktures me inmfrastrukturen e zones.
- 8-Grafiku i punimeve dhe mbikqyrjes ne objekt
- 9-Plani i organizimit te punimeve
- 10-Projekti arkitektonik
- 11- Projekti teknik i ndertimit
- 12- Projekti i mbrojtjes nga Zjarri
- 13-Preventivi i realizimit te punimeve
- 14- Studim gjeologo-inxhinjerik dhe hidrogjelogjik
- 15- Studim sizmiko-inxhinjerik
- 16- Vertetim i kategorise se bonitetit te tokes
- 17-Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis
- 18-Miratimin nga Agjensia Rajonale e Mjedisit
- 19-Miratim nga Autoriteti administrues i pyjeve ne nivel vendor
- 20-Vertetim nga Instituti i Monumenteve te Kultures
- 21-Dokument vertetues, autorizues ose leje e Autoriteteve te Ujit.
- 22- Dokument vertetues, autorizues ose Autoritetit te Kullota/livadheve
- 23- Vertetim per zonat me perparesi Turizmin

Keto dokumenta se bashku me kerkesen dorezohen ne rruge zyrtare nga zhvilluesi, e vleresohen nga ministria e linjes.

2. Brenda 5 ( pese ) diteve nga data dorezimit, shqyrtohet kerkesa per ceshtje te formes (paraqitjes se dokumentacionit te kerkuar si me siper), dhe njoftohet zhvilluesi nese ka nevoje per plotesime apo do te vazhdoje procedura e shqyrtimit te perputhshmerise se projektit.
3. Njesia perkatese e MEI qe mbulon fushen e aktivitetit per objektet per te cilat aplikohet per leje zhvillimore me miratim te kryetarit te komisionit, ben afishimin ne faqen zyrtare te Web te MEI, duke e lene 10 dite per shprehje te verejtjeve etj per kete aplikim.
4. Kur nga verifikimi paraprak i dosjes rezulton se dokumentacioni nuk eshte i plote, subjekti njoftohet duke lene afat 30 ( tridhjetete ) ditore per plotesimin e mangesive.

*Procedura e shqyrtimit te dosjes se aplikantit per leje zhvillimore ne MEI realizohet ne perputhje ligjin e VKM e sipercituar dhe me Udhezimin nr 1, date 30.10.2013 te Ministrit, ne zbatim te tyre.*

*Per shqyrtimin e kerkesave ngrihet nje komision i kryesuar nga Sekretari i Pergjithshem i MEI dhe perfaqesues nga drejtorite e linjes te ministrise dhe eksperte te fushave.*

*Komisioni mblidhet rast pas rasti sa here kerkohet shqyrtim i praktikave per paisje me leje zhvillimore, ku njoftohen per pjesmarrje e mbrojtje pala e interesuar.*

5. Nëse dokumentacioni është i plotë vazhdon procedura sipas këtij Udhezimi, ku dërgohet njoftim në Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të territorit ( AKPT ), për vlerësim dhe pasqyrim në regjister, si dhe përcillet kërkesa për marrje mendimi oponent nga institucione ose eksperte të fushës.
6. Përgatitet dosja me një raport shoqëruar për përmbushjen në formë të kërkesave të aplikimit, për komisionin e MEI, pasi të jete marrë edhe mendimi oponent nga institucione apo eksperte të fushës.
7. Komisioni mbledhet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga paraqitja e dokumentacionit të plotë përfshirë edhe mendimet opONENTE.
8. Komisioni pas shqyrtimit sipas pikës 7 të Udhezimit, harton proces-verbalin përkatës, dhe dosja e aplikantit së bashku me vlerësimin e MEI dërgohet në AKPT për procedim të mëtejshëm për shqyrtim në Këshillin Kombëtar të Territorit ( KKT ).
9. Në rast refuzimi, njoftohet subjekti duke trajtuar edhe shkaqet përkatëse. Subjekti ka të drejtë, që brenda 30 ( tridhjetë ) ditëve të bëjë plotësimin e mangësive të vërejtura nga komisioni, e pastaj ky komision brenda 15 ( pesëmbëdhjetë ) ditëve rishqytron aplikimin e paraqitur dhe merr vendimin përkatës. Në rast kthimi për herë të dytë të dokumentacionit, subjekti ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.
10. Pasi KKT shqyrton dosjen e aplikantit, dhe merr vendimin përkatës, nëpërmjet AKPT-se e përcjell atë në MEI. Struktura përgjegjëse e MEI përgatit dokumentacionin teknik për Ministrin.
11. Dokumentacioni teknik formulari TIP 3 ose 5 (shtojca 2 VKM 502, datë 13.07.2011, i ndryshuar), ose LEJA ZHVILLIMORE firmoset nga Ministri në dy kopje, ku një prej tyre i dorëzohet subjektit sipas procedurave ligjore.